


2011

P Z A P
I P Ž P



RAPORTI VJETOR I PZAP-it

1 Mars 2011 - 31 Dhjetor 2011

PZAP, Rr. "Luan Haradinaj" Ndërtesa e ish Bankës së Lubjanës.
Kati - I - zyra nr. 9 kod postar 10000 Prishtinë



PËRMBAJTJA

HYRJA - STATUSI I PZAP-IT	1
MISIONI I PZAP-IT	1
STRUKTURA DHE BURIMET NJERËZORE.....	2
KRYESUESI DHE ANËTARËT E PZAP-IT	2
FUNKSIONET, PËRGJEGJËSITË DHE PËRBËRJA E SEKRETARIATIT TË PZAP-IT	3
ORGANOGRAMI I PZAP-it	5
AKTIVITETET E PZAP-IT DHE SEKRETARIATIT GJATË NJË VITI JO-ZGJEDHOR.....	6
NXJERRJA E KONKLUZIONEVE NGA TAKIMET	7
PJESËMARRJA E ANËTARËVE TË PZAP-IT NË GRUPE TË NDRYSHME PUNUESE	8
KOMISIONET E PËRHERSHME TË PZAP-IT	9
BUXHETI I PZAP-IT PËR VITIN 2011.....	11
PJESA PËRMBYLLËSE E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE	17
TË HYRAT E PZAP-IT	18
PËMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE STATISTIKA PËR ZGJEDHJET 2010/2011	20
JURIDIKSIONI I PZAP-IT	21
PËRBËRJA E PANELIT	22
PROCEDURAT E PZAP-IT	23
SEANCAT E PANELIT	24
NATYRA E ANKESAVE TË PARAQITURA NË PZAP, GJATË PROCESIT ZGJEDHOR 2010/2011	25
RASTET E DORËZUARA NË PROKURORIN E SHTETIT	27
SANKSIONET	28

1. PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)

1.1 Hyrja - Statusi i PZAP-it

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, i ushtron funksionet dhe përgjegjësit e tij sipas nenit 115 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe Ligjit Nr. 03/L-256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës (Ligji nr 03 / L-072).

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ¹ është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është përcaktuar me ligjin dhe rregullat zgjedhore.

PZAP, ju përmbahet dhe zbaton me përgjegjësi Rregullat Zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ-së) dhe Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it të nxjerrura me 8 Tetor 2009 të cilat janë amandamentuara dy here përputhje me nenin 117.1 të LZP-së me 23 Qershor 2010, dhe me 17 nëntor 2010.

1.2 Misioni

Misioni i PZAP-it, është mbrojtja e të drejtave zgjedhore, respektivisht Zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike sipas standardeve ndërkombëtare, si për nivelin qendror ashtu edhe për nivelin lokal.

¹ Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP) Nr. 03/L-073

1.3 Struktura dhe burimet njerëzore

Siç parashihet me Ligjin Nr. 03/L-256, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, me vendimin Agj.nr. 685/2010 të datës 08.11.2010, anëtarët e PZAP-it, duke përfshirë këtu edhe kryetarin janë emëruar nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.

2. KRYESUESI DHE PËRBËRJA E PANELIT TE PZAP-it²

1. Shukri Sylejmani, Gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës, Kryesues i PZAP-it
2. Ymer Hoxha, Kryetar i Gjykatës së Qarkut – Prizren, anëtarë,
3. Muharrem Shala, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Pejë, anëtarë,
4. Hasan Shala, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Pejë, anëtarë,
5. Xhevdet Abazi, Kryetar i Gjykatës së Qarkut – Mitrovicë, anëtarë,
6. Ferit Osmani, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Mitrovicë, anëtarë,
7. Nehat Idrizi, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Prishtinë, anëtarë,
8. Rafet Haxhaj, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Prishtinë, anëtarë,
9. Muhamet Rexha, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Gjilan, anëtarë,
10. Vlastimir Dimić, Gjyqtar i Gjykatës së Qarkut – Gjilan, anëtarë.

² Agj.nr. 685/2010 të datës 08.11.2010

3. FUNKSIONET PËRGJEGJËSIT DHE PËRBËRJA E SEKRETARIATIT TE PZAP-it

Në bazë të nenit 123 të LZP-së³, PZAP-i, në ushtrimin e përgjegjësive dhe funksioneve të tij ndihmohet nga Sekretariati i cili punon në pajtim me këtë ligj.

Sekretariati i PZAP-it:

- a) pranon ankesa dhe apele;
- b) arkivon, përkthen dhe harton rastet;
- c) mirëmban adresa zyrtare dhe qasje në informatat në çdo kohë rreth vendimeve të PZAP-it në të gjitha gjuhët zyrtare sipas Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

Kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it nën udhëheqjen e Kryetarit të PZAP-it, është përgjegjës për:

- a) të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e PZAP-it;
- b) përgatitjen e paneleve të PZAP-it, duke siguruar se i tërë materiali i nevojshëm është në dispozicion;
- c) organizimin e Sekretariatit dhe nxjerrjen e procedurave administrative për çfarëdo çështje që ka të bëjë me funksionimin e PZAP-it.
- d) Për menaxhimin e buxhetit vjetor të ndarë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për të mbuluar shpenzimet për funksionimin e duhur të Sekretariatit, duke u bazuar në propozim buxhetin e dorëzuar nga Kryetari i Gjykatës Supreme.

³ Neni 123 LZP


PZAP - Sekretariati i PZAP-it⁴, me organogram dhe buxhet për vitin 2011/2012, ka të planifikuara dhe të miratuara 20 (njëzetë) pozita. Prej tyre 10 (dhjetë) anëtarë të Panelit, Kryetari dhe 9 (nëntë) anëtar, si dhe 10 (dhjetë) zyrtarë të personelit të Sekretariatit, Kryesuesi i Sekretariatit dhe 9 (nëntë) zyrtarë të tjerë të administratës të sekretariatit.

Marrëdhënia e punës së personelit të Sekretariatit të PZAP-it, rregullohet me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës i datës 13 maj 2010.

Struktura e PZAP-it është e prezantuar në skemën e me poshtme. Siç duket nga kjo skeme në strukturën e PZAP-it ka 10 (dhjetë) anëtarë përfshirë këtu kryesuesin dhe 9 (nëntë) anëtar, ndërsa Sekretariati i PZAP-it ka 10 (dhjetë) zyrtarë të personelit, Kryesuesin e Sekretariatit, Udhëheqësin e Zyrës Ligjore, tre Zyrtarë të Lartë Ligjorë, Zyrtarin Kryesor Financiar, Koordinatorin për Përkthim, Shqip - Serbisht dhe anasjelltas, Asistentin Ekzekutiv dhe Zyrtarin e Transportit.

⁴ Organogrami i SPZAP-it

Organogrami i PZAP-it



4. AKTIVITET E PZAP-it DHE TE SEKRETARIATIT GJATË NJË VITI JO ZGJEDHOR

4.1 Rekrutimi i personelit të Sekretariatit të PZAP-it

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës⁵ të datës 13 maj 2010. PZAP-i ka bërë rekrutimin e personelit të tij duke përfshirë këtu 1 (një) Zyrtarë të Lartë Ligjorë, 1 (një) Zyrtare Kryesore Financiare dhe 1 (një) Asistente Ekzekutive dhe në këtë mënyrë ka kompletuar stafin e Sekretariatit të lejuar me buxhet e vitit 2011/2012.

4.2 Vlerësimet e punës për personelin e Sekretariatit të PZAP-it

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 13 maj 2010. Është bërë vlerësimi i punës për zyrtaret e sekretariatit dhe ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit në afat të pacaktuar për pozita të karrierës.

4.3 Takimet e Punës të cilat PZAP-i i ka organizuar dhe ato në të cilat ka marrë pjesë me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të tij.

Takimi i mbajtur në Durrës nga data 10 – 13 maj 2011 të cilin e ka organizuar dhe përkrahur Divizioni i Zgjedhjeve i OSBE-së⁶.

Në këtë takim janë diskutuar çështjet Mësimet e Nxjerra nga Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2010/2011,

⁵ Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 13 maj 2011

⁶ Punëtorja e mbajtur në Durrës, organizuar nga DZ i OSCE-së

Vlerësimi i procesit Zgjedhor të vitit 2010/2011 nga vëzhguesit ndërkombëtar: Misioni i Eksperteve të Zgjedhjeve të BE-së (EUEEM), Rrjeti Evropian i Organizatës për Monitorimin e Zgjedhjeve (ENEMO),

Koordinimi i PZAP-it me Institucionet tjera (Policinë e Kosovës, Prokurorin e Shtetit, KQZ-ne etj) gjatë procesit Zgjedhor 2010/2011,

Korniza Ligjore, boshllëku apo te metat e kësaj kornize që janë vërejtur gjatë procesit Zgjedhor 2010/2011,

Diskutimi për Skemën e Gjobave dhe hartimin e Draft - Rregullores për caktimin dhe zbatimin e gjobave ndaj subjekteve politike gjatë procesit zgjedhor ne te ardhmen.

Prezantimi i raportit për Zgjedhjet Parlamentare te vitit 2010/2011.

Takimi i mbajtur në Durrës⁷ nga data 10 – 12 nëntor 2011 të cilin e ka organizuar PZAP-i. Në këtë takim kanë marrë pjesë anëtarët e PZAP-it dhe personeli i Sekretariatit të PZAP-i përfaqësues nga OSBE-ja dhe Kryetarja e KQZ-së dhe janë diskutuar çështjet lidhur me rekomandimet – konkluzionet për reformën zgjedhore që kanë të bëjnë me Statusin - mandatin e PZAP-it, te cilat rekomandime i janë propozuar GPZ-së.

5. NXJERRJA E KONKLUZIONEVE NGA TAKIMET

5.1 Formimi i Dy komisioneve të përhershme të PZAP-it:

- Komisioni për Çështje Ligjore i përberë prej 5 (pese) anëtarëve të panelit,
- Komisioni për Buxhet dhe Personel i përberë prej 5 (pese) anëtarëve të panelit,
- Caktimi i anëtarit dhe zëvendës anëtarit të PZAP-it për të marrë pjesë në Grupin Punues të Zgjedhjeve (GPZ).

⁷ Punëtorja e mbajtur ne Durrës, organizuar nga SPZAP date 10-12.2011

Kryetari i PZAP-it ka përfaqësuar PZAP-in ne këto takime dhe duke u mbështetur ne mendimet, qëndrimet dhe rekomandimet e anëtarëve të Panelit ne emër të PZAP-it, këto i ka transmetuar GPZ dhe në këtë mënyrë ka dhënë kontributin e tij për Reformën Zgjedhore sa i për ketë statusit te PZAP-it, ashtu edhe për çështjet tjera për Reformën Zgjedhore.

6. Pjesëmarrja e Anëtarëve të PZAP-it dhe Personelit të Sekretariatit të PZAP-it në Vizita dhe Grupe Punuese në Vend dhe Jashtë Vendit.

6.1 Vizita në Maqedoni

Një delegacion i PZAP-it i kryesuar nga Kryetari i PZAP-it, në të cilin pjesëmarrës kanë qenë edhe Kryesuesi i Sekretariatit dhe Zyrtari i Lartë Ligjorë, kanë marrë pjesë në vëzhgimin e zgjedhjeve Parlamentare në Maqedoni të mbajtura me 05 qershor 2011.

Kryetari i PZAP-it, ka marrë pjesë në të gjitha takimet lidhur me reformën zgjedhore të GPZ-së të mbajtura në vend dhe jashtë vendit.

6.2 Vizita në Turqi

Kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it bashkë me dy zyrtar të lart të Sekretariatit; Udhëheqësin e Zyrës Ligjore dhe Zyrtarin Kryesor Financiar kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga Instituti Kosovar për Menaxhim i cili është mbajtur nga data 26 – 30 tetor 2011 në Stamboll të Turqisë.

Tema e këtij takimi ka qenë “Menaxhimi i Shpenzimeve Publike dhe Përgatitja e Pasqyrave Vjetore Financiare”.

7. KOMISIONET E PËRHERSHME TË PZAP-it

Në bazë të ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës, PZAP-i, me qëllim të ushtrimit të funksionit dhe përgjegjësisë të tij ka të formuara disa komisione të Përhershme siç janë:

- 1 Komisioni për Çështje Ligjore i përberë prej 5 (pese) anëtarëve të panelit,
- 2 Komisioni për Buxhet dhe Personel i përberë prej 5 (pese) anëtarëve të panelit,
- 3 Komisioni Disiplinor i përberë prej zyrtareve të lartë të Sekretariatit,
- 4 Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i përberë prej Zyrtareve të Lartë të Sekretariatit,

Komisionet nën nr. rendor 1 dhe 2 janë komisione të përhershme të cilat përbehen nga anëtarët e PZAP-it dhe të cilat në mënyrë të përhershme do të merret me çështjet ligjore që kanë të bëjnë me fushën e kompetencave dhe të mandatit të Institucionit të PZAP-it të përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe Lokale në Republikën e Kosovës dhe amendamentimin e Rregullave dhe Procedurave të brendshme të PZAP-it dhe me çështjet e buxhetit dhe të personelit të PZAP-it. Ndërsa komisionet nën nr. rendor 3 dhe 4 janë komisione të përhershme të cilat merren me çështjet e procedurave disiplinore dhe të ankesave të personelit të administratës së Sekretariatit, respektivisht me çështjet e marrëdhënies së punës të shërbyesve civil të sekretariatit.

7.1 Komisionet përkohshme të PZAP-it

Komisioni për Inventarizimin e Pasurisë

Komisioni për Vlerësimin e Pasurisë dhe

Komisione tjera të përkohshme që janë të obligueshme në bazë të ligjit për përmbushjen e aktiviteteve të PZAP-it.

7.2 Zyra Ligjore

Aktivitetet e Zyrtarëve të Zyrës Ligjore kanë qene si në vijim:

Aktiviteti lidhur me Mësimet e nxjerra nga zgjedhjet e kaluara, mangësitë dhe përparësitë e LZP-së dhe rregullave tjera zgjedhore,

Rekomandimet për ndryshimin e disa neneve të LZP-së,

Rekomandimet lidhur me statusin e PZAP-it për GPZ,

Përgatitja e një draft rregulloreje për skemën e gjobave,

Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës dhe me Prokurorin e Shtetit lidhur me rastet që kanë elemente të veprës penale në bazë të KPK, për zgjedhjet 2009/2010 dhe për zgjedhjet 2010/2011,

Kthimi i përgjigjeve në kërkesat e parashtruar nga gjykatat e ndryshme komunale nëpër Kosovë për rastet që janë në procedurë lidhur me zgjedhjet e kaluara,

Paralajmërimi i subjekteve politike për pagesën e gjobave të shqiptuara nga PZAP-i,

Bashkëpunimi në vazhdimësi PZAP-it me Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC) të Komisionit Qendror Zgjedhor – KQZ-së, lidhur me të gjitha aktivitetet e ndërlidhura të përcaktuara me LZP.

Kategorizimi i ankesave dhe vendimeve të ndryshme nga zgjedhjet 2010/2011.

7.3 Shërbimet e përbashkëta dhe Investimet Kapitale

Blerja e Automjetit për nevoja të PZAP-it,

Blerja e Pajisjeve të Teknologjisë Informativë – Kompjuter etj.

Renovimi i hapësirave të PZAP-it në ndërtesën e ish Bankës së Lubjanës, ndërtesë të cilën e ka shfrytëzuar OSBE-ja,

Zhvendosja e stafit, pajisjeve dhe materialeve tjera të zyrës nga ndërtesa e ish Gërmisë si dhe akomodimi në ndërtesën e ish Bankës së Lubjanës, ndërtesë të cilën e ka shfrytëzuar OSBE-ja.

8. BUXHETI I PZAP-it PËR VITIN 2011

8.1 Fondi i alokuar nga Buxheti i Shtetit për vitin 2011 për PZAP-in ka qenë:

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa është organizatë buxhetore, me kod organizativ 247 dhe me kod funksional 0170. PZAP-i financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës

Raporti vjetor i shpenzimeve për vitin fiskal 2011 përmban të gjitha shpenzimet e krijuara gjatë këtij viti. Ky raport është përgatitur në pajtim me Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) (03/L-48) dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) dhe sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë periudhës së realizimit të shpenzimeve.

Bazë për hartimin e dokumentit kanë shërbyer raportet e Sistemit Informativë për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK), të dhënat nga sektori i financave si librat, faturat, raportet e pranimit të mallit, kontratat dhe dokumentet tjera të PZAP-it.

Të gjitha pagesat janë bërë në sistemin e kesh-it (parave të gatshme) e jo të zotimit.

Valuta raportuese është euro (€).

Shumat raportuese janë në njësi në €

8.2 Buxheti i planifikuar i PZPA-it për vitin 2011

Për vitin 2011 për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa Qeveria e Republikës së Kosovës i ka ndare buxhet në shumë prej 276,649.00€


8.3 Buxheti i aprovuar i PZAP për vitin 2011

Përshkrimi	Buxheti i aprovuar 2011	Total Buxheti
Paga dhe mëditje	144,847.00	144,847.00
Mallra dhe shërbime	99,602.00	99,602.00
Shërbime Komunale	9,200.00	9,200.00
Shpenzime kapitale	23,000.00	23,000.00
Total	276,649.00	276,649.00

8.4 Struktura e buxhetit për vitin 2011

Duke analizuar buxhetin e PZAP-it ne shume prej 276,649.00 € si dhe strukturën buxhetore rezulton se prej tyre:

- 52.35 % të fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe mëditje,
- 36 % të fondeve është akorduar për shpenzime mallra dhe shërbime,
- 3.3% për shpenzimet komunale dhe
- 8.31% të fondit për shpenzime kapitale.



8.5 Buxheti i shpenzuar për vitin 2011

Pas aprovimit të buxhetit për vitin 2011, në përputhshmëri me planin operacional, është bërë menaxhimi i fondeve të akorduara për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa. Buxheti është realizuar me korrektësi sipas zërave të shpenzimeve dhe me efektivitet duke treguar kujdes që fondet e miratuara të shpenzohen sipas planit në kohën e duhur dhe me një administrim ekonomik efektiv.

Realizimi i buxhetit, përkatësisht shpenzimet e PZAP-it për vitin 2011 sipas kategorive ekonomike i shprehur edhe në përqindje duket në vijim:

Buxheti i Shpenzuar -2011 në €

Kategoritë Ekonomike	Total buxheti i Aprovuar	Buxheti i shpenzuar	Përqindja (%)
Paga dhe mëditje	144,847.00	104,650.82	72.25%
Mallra dhe shërbime	99,602.00	74,372.19	74.67%
Shërbime Komunale	9,200.00	1,596.79	17.36%
Shpenzime kapitale	23,000.00	15,280.00	66.43%
Total:	276,649.00	195,899.80	70.81%

a. Paga dhe mëditjet

Për vitin 2011 për Kategorinë se Pagave dhe Mëditjeve janë planifikuar mjete në vlerë prej 144,847.00€ Janë realizuar 104,650.82€apo buxheti është shpenzuar 72.25%.

Dallimi në mes të Planifikimit dhe realizimit të Buxhetit është se të gjithë anëtarët e Panelit pagën në PZAP e marrin si pagë sekondare ndërsa ne jemi të obliguar të planifikojmë

Buxhetin në bazë të Vendimit të Qeverisë, andaj nga kjo del ndryshimi në mes Buxhetit të Planifikuar dhe të Realizuar sa ju përket kategorisë së Pagave dhe Mëditjeve.

b. Mallra dhe shërbime

Për vitin 2011, janë planifikuar mjete në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në shumë prej 99,602.00€. Këto mjete u shpenzuan në shumë prej 74,372.19€ apo buxheti është shpenzuar 74.67% . Këto shpenzime janë realizuar nëpërmjet:

- Moduli të aprovimeve dhe
- Moduli të blerjeve-prokurimit.

Me poshtë janë të prezantuara shpenzimet e kategorisë në mallra dhe shërbime për vitin 2011.

Mallra dhe shërbime në €

Kategoritë ekonomike	Shpenzimet -2011
Mallra dhe Shërbime	74,372.19
Shpenzimet e udhëtimit	11,678.11
Shërbimet e Arsimit dhe trajnimit	2,397.00
Shërbimet tjera telefonike vala 900	8,290.00
Shërbimet kontraktuese tjera	7,470.65
Mobile me vlerë me pak se 1,000 euro	6,640.00
Harduer për teknologji informative < 1000	9,477.20
Furnizimi për Zyre	9,520.00
Furnizime pastrimi	25.02
Karburant për vetura	7,789.60
Shërbimet postare	18.35
Regjistrimi, sigurimi i automjeteve	1,576.00
Mirëmbajtja,riparimi i automjeteve	1,276.95
Mirëmbajtja e ndërtesave	5,232.57
Reklamat dhe konkurset	859.12
Shpenzimet për informim publik	530.72
Drekat zyrtare	1,590.10

c. Shpenzimet komunale

Buxheti i aprovuar i shpenzimeve komunale për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa është ne shumë prej 9,200.00€ Krahasuar me buxhetin e planifikuar shpenzimet u realizuan 17.36%, çka do te thotë se buxheti është shpenzuar 1,596.79€

d. Shpenzimet Kapitale


Ne buxhetin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa të vitit 2011, shpenzimet kapitale janë planifikuar ne shumë prej 23,000.00 € Shuma e shpenzuar e këtyre mjeteve është në vlerë prej 15,280.00€ përkatësisht 66% e

buxhetit të planifikuar për këtë kategori. Shpenzimet e realizuara kanë të bëjnë me blerjen e një veture të re për nevojat e PZAP-it.

9. PJESA PËRMBYLLSE E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE

Në bazë të dhënave të SIMFK dhe databazës të Sekretariatit të PZAP-it mund të përfundojmë se për vitin 2011 Buxheti u shpenzua **195,899.80€** Pjesë përmbyllëse e këtij raporti të shpenzimeve është paraqitja grafike e planifikimit dhe realizimit të Buxhetit për vitin 2011.

Paraqitja grafike e buxhetit të planifikuar dhe shpenzuare PZAP-it për vitin 2011



10. TE HYRAT E PZAP-it

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP-i) në bazë të nenit 120 paragrafi 1. pika c. të Ligjit Nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, për shkak të shkeljeve dhe parregullsive që kanë ndodhur në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 12 dhjetor 2010, ka vendosur gjopa ndaj subjekteve politike në shumë prej 377,450.00 euro.

Të Hyrat e realizuara për vitin 2011

Nr	Subjekti politik	Shuma	Pagesa	Mbetja
1	PDK	148,400.0	148,400.00	0.00
2	LDK	88,050.00	88,050.00	0.00
3	AAK	77,600.00	77,600.00	0.00
4	AKR	38,850.00	38,850.00	0.00
5	LDD	9,200.00		9,200.00
6	LVV	6,250.00	6,250.00	0.00
7	FER	3,050.00		3,050.00
8	KDTP	3,050.00	3,050.00	0.00
9	SLS	3,000.00	3,000.00	0.00
Total:		377,450.0	365,200.0	12,250.00

Në tabelën e mësipërme janë pasqyruar të dhënat me emrin e subjekteve politike, shumën e gjobave të shqiptuara, pagesën e gjobave të shqiptuara dhe gjobat e pa paguara.

Subjektet Politike: Partia e Pavarur Liberale (Samostalna Liberalna Stranka (SLS), Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Turke, Kosovo Demokratik Turkish Partis (KDTP) i kanë paguar borxhet ndaj PZAP-it para datës 24 mars 2011, në mënyrë të rregullt. Ndërsa për subjektet tjera Politike është vendosur në bazë të nenit 18 të Ligjit Nr. 03/L-174 Për Financimin e Subjekteve Politike. Partisë Demokratike të Kosovës (PDK-së), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-së), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, (AAK-së) dhe Aleancës për Kosovën e Re (AKR-së) për mospagimin e detyrimeve, respektivisht gjobave ndaj PZAP-it, KQZ-ja u ka zbritur buxhetin e Fondit për mbështetjen e subjekteve politike të ndarë për vitin 2011 dhe njëherësh buxhetin e zbritur - ndalur e ka transferuar - bartur përmes thesarit në fondin e te hyrave të PZAP-it, respektivisht në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Realizimi mbledhja e këtyre borxheve është arritur falë bashkëpunimit shumë të mirë institucional në mes të KQZ-së dhe PZAP-it.

Subjektet Politike te cilat ende nuk i kanë shlyer borxhet ndaj PZAP-it janë Lidhje Demokratike e Dardanisë (LDD) dhe Fryma e Re (FeR-i).

PZAP-i, deri me tani për vitin 2011 nga shumat e gjobave të shqiptuara ndaj subjekteve politike prej 377,450.00 euro, ka mbledhur 365,200.00 euro qe do të thotë se ky fond i mbledhur transferohet dhe mbahet ne Buxhetin e Konsoliduar te Kosovës.

Financimi përkrahja nga donatorët:

Gjatë vitit 2011 PZAP-i, ka përfituar nga takimet e punës të organizuara nga OSBE-ja me temën mësimet e nxjerra nga zgjedhjet e kaluara. Në këto takime kanë marrë pjesë anëtarët e panelit dhe personeli i Sekretariatit të PZAP-it.

11. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE STATISTIKA PËR ZGJEHJET 2010/2011

Gjatë periudhës kohore prej 1 nëntor 2010 deri me 28 shkurt 2011, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka dëshmuar se është organ apolitik, i pavarur, i vendosur dhe i aftë në zgjidhjen e rasteve të ndryshme gjatë procesit të Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare 2010/2011, në mënyrë të drejtë dhe në afatet e parapara ligjore. PZAP është udhëhequr nga parimet e paanësisë politike, konfidencialitetit dhe profesionalizmit. Performanca e treguar e këtij Institucioni është bërë e njohur për publikun dhe zyrtaret e Institucioneve të vendit si dhe është treguar e vërtet dhe me kredibilitet.

PZAP-i, ka kryer me sukses funksionin e tij, ku brenda periudhës së lartcekur ka vendosur 454 ankesa, të cilat kanë qenë brenda juridiksionit të PZAP-it, prej këtyre ankesave; 33 % janë vendosur në favor të palëve ankuese, 67 % janë refuzuar apo janë hedhur poshtë si të pasafatshme dhe të parakohshme. Vendosja për të gjitha ankesat nga PZAP-i, në afatin e paraparë ligjor i ka mundësuar, Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), certifikimin e rezultateve të Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare 2010/2011.

PZAP, brenda juridiksionit të tij, ka shqiptuar gjopa ndaj subjekteve politike në shumë prej 377.450,00 euro. Ju është ndaluar e drejta për të marrë pjesë në zgjedhjet e ardhshme të 4 personave, Fatos Selimi, kryesues i Vendvotimit QV 1911e/01, Vesel Krasniqi në cilësinë e Komisionarit në QV 3032A/042, Behlul Limaj simpatizant i PDK-se, Isa Berisha në cilësinë e Koordinatorit të vëzhguesve në QV 2006a dhe të gjithë komisionarëve të cilat kanë marrë pjesë në procesin administrativ zgjedhor të rivotimit të datës 09 janar 2011 në Komunat: Skenderaj, Deçan, Gllogoc, dhe në fshatin Drenoc Komuna e Malishevës.

PZAP-i pasi që ka marrë vendim administrativ për secilin rast i ka dorëzuar në Prokurorinë e Shtetit 198 raste, të cilat kanë të bëjnë me rastet e përgjegjësisë individuale dhe që kanë pasur elemente të veprës penale, që kanë ndodhur gjatë

procesit zgjedhor 2010/2011, dhe që bien kundërshtim me Kodin Penal të Kosovës (KPK).

12. JURISDIKSIONI I PZAP-it

PZAP-i, në bazë të nenit 115 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe Ligjit Nr. 03/L-256, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës (Ligji nr 03 / L-072) është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është përcaktuar me ligj dhe rregullat zgjedhore.

PZAP-i, zbaton me përgjegjësi, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe Ligjit Nr. 03/L-256, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës (Ligji nr 03 / L-072), Rregullat Zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) dhe Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, të miratuara me 8 Tetor 2009, të cilat janë ndryshuar dy herë në përputhje me nenin 117.1 të LZP-së me 23 Qershor 2010, dhe me 17 nëntor 2010.

13. PËRBËRJA E PANELIT

PZAP-i, përbëhet nga dhjet (10) anëtar, përfshirë edhe kryesuesin. PZAP mund të mbledhet në panele prej së paku tre (3) anëtarëve. Anëtarët e emëruar të PZAP-it gjashtëdhjetë (60) ditë para ditës së zgjedhjeve deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve i japin përparësi të plotë obligimeve të tyre si anëtarë të PZAP-it. Poashtu, LZP-ja i obligon të gjitha autoritetet kosovare t'i ofrojnë tërë ndihmën e nevojshme PZAP-it, gjatë periudhës së lartpërmendur.

PZAP-i, përbëhet nga një Kryetar i Panelit, i cili do të jetë kryesues në të gjitha takimet e Panelit në përbërje të plotë, dhe nga nëntë anëtarë të Panelit. PZAP mban mbledhje në panele të përbëra prej tre (3) anëtarëve të panelit. Një (1) anëtar i panelit emërohet kryesues i të gjitha paneleve. Kryetari i Panelit do të caktojë përbërjen e paneleve. Kryetari i Panelit mund të krijojë një panel që do të përbëhet nga të gjithë anëtarët e Panelit lidhur me çështjet e rëndësisë së jashtëzakonshme.

Anëtarët e Panelit do t'i plotësojnë detyrat e veta me kohë dhe në mënyrë objektive, të paanshme dhe apolitike, si dhe do t'i mbajnë konfidenciale të gjitha informatat e dorëzuara tek ata në cilësinë e anëtarëve të Panelit.

Në vitin 2010, me vendimin Agj.nr. 685/2010 të datës 08.11.2010, anëtarët e PZAP-it, duke përfshirë këtu edhe kryetarin janë emëruar nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, siç parashihet me Ligjin Nr. 03/L-256, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Emërimi i anëtarëve të PZAP-it, është bërë në bazë të nenit 115.2 të LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 03/L-256, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës i cili përcakton se: Kryetari i Gjykatës Supreme emëron anëtarët e PZAP-it nga mesi i gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe Gjykatave të Qarkut në Kosovë.

14. PROCEDURAT E PZAP-it

Gjatë vendosjes për një ankesë ose apel PZAP-i, ka shqyrtuar dhe hetuar të gjitha dëshmitë relevante që kanë qenë të nevojshme për marrjen e një vendimi. Vendosja për ankesa dhe apele është mbështetur në dëshmi të qarta dhe bindëse. Vendimet e PZAP-it, janë publikuar ne ueb faqen e PZAP-it në pajtim me LZP, rregullat dhe procedurat e brendshme te PZAP-it si dhe pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve në Republikën e Kosovës.

PZAP – i gjatë procesit të shqyrtimit të ankesave ka zbatuar metoda të ndryshme për të mbledhur faktet e nevojshme për marrjen e vendimeve të drejta, respektivisht vendosjen e ankesave në mënyrë meritore. Në lidhje me hetimin e materialit zgjedhor, siç përcaktohet në Nenin 12 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, kur një ankesë e dyshuar për veprimtari mashtruese që përfshinë materialin zgjedhor, Kryesuesi i Panelit ka caktuar një anëtar të Sekretariatit të PZAP-it, si hetues kryesor në lidhje me atë ankesë. PZAP-i, në mënyrë të rregullt ka bashkëpunuar me Policinë e Kosovës, në veçanti në lidhje me rastet e dyshuara të kërcënimeve, dhunës, kanosjes, shantazheve dhe dëmtimit të pronës publike gjatë procesit zgjedhor, andaj falë bashkëpunimit shumë të mirë me Policinë e Kosovës, duke u bazuar në raportet hetimore të Policisë PZAP-i, ka marrë vendime brenda afatit ligjor në lidhje me rastet.

15. FAKTE DHE STATISTIKA

Më poshtë, mund të gjenden fakte dhe statistika të cilat në mënyrë të hollësishme shpjegojnë seancat e paneleve të mbajtura, llojet e ankesave dhe apeleve të pranuar, rastet e paraqitura në Prokurorinë e Shtetit si dhe tabela e gjobave ndaj subjekteve politike, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur.

16. SEANCAT E PANELIT

Paneli i PZAP-it sipas nevojës, varësisht nga numri i rasteve të paraqitura të ankesave, parashtrësive apo apeleve ka mbajtur seanca, deri tri herë në javë.

PZAP-i për procesin zgjedhor për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2010/2011, duke filluar nga 01.11.2010 deri me 28.02.2011, ka mbajtur Gjithsejtë 21 seanca. Gjatë mbajtjes së këtyre Seancave paneli i PZAP-it ka shqyrtuar 454 ankesa për të gjitha këto ankesa ka marr vendime meritore. Gjatë shqyrtimit të këtyre ankesave PZAP-i ka konstatuar dhe vendosur si ne vijim: si të bazuara 150 ankesa, të pabazuara 188 ankesa, të palejuara 88 ankesa, të pasafatshme 22 ankesa, dhe të parregullta 6 ankesa. Poashtu gjatë këtyre seancave Paneli ka konstatuar dhe vendosur edhe për 15 apele. Si i bazuar ka qenë 1 apel, të pabazuar 5 apele, të palejuara 2 apele, të pasafatshme 7 apele.

Duke u bazuar në Rregullat dhe Procedurat e brendshme, për shkak të racionalizimit të kohës dhe ngjashmërisë së rasteve PZAP-i ka marrë 15 vendime me të cilat janë vendos 121 ankesa. Ndërsa për të gjitha ankesat tjera PZAP-i ka marrë 333 vendime të veçanta për secilën ankesë.

17. NATYRA E ANKESAVE TE PARAQITUAR NE PZAP GJATË PROCESIT ZGJEDHOR 2010/2011

Gjatë periudhës së procesit zgjedhor 2010-2011, llojet e Ankesave dhe Parashtrësve të pranuar në PZAP kanë qenë: Për shkeljen e Kodit të Mirësjelljes – 147, Kërcënim, Frikësim dhe Shantazhim – 33, Parregullsi gjatë procesit të votimit me 12 dhjetor 2010 – 175, Parregullsi gjatë procesit të rivotimit me 09 Janar 2011 – 69, Parregullsi gjatë procesit të rivotimit me 23 Janar 2011 – 11, Mospërputhje e rezultateve gjatë procesit të numërimit prej QV ne QNR, Kontestimi i publikimit të rezultateve përfundimtare 19.

PZAP-i, i ka vendosur si të bazuara 149 ankesa; që prej tyre kanë rezultuar me gjoba gjithsej 105 ankesa; për anulim/rivotimin e datës 09 janarit 2011 gjithsej 23 ankesa dhe që për rinumërim gjithsejtë 21 ankesa si dhe ka vendosur si të pabazuara gjithsejtë 305 ankesa.

Numri i përgjithshëm i ankesave që janë parashtruar në PZAP, gjatë procesit zgjedhor 2010/2011, janë 454.

Lista e mëposhtme vërteton ankesat e ardhura nga secila komunë veç e veç:

Ankesat ne PZAP - Lista e pikave të ndjeshme për çdo Komunë	
Dragash	5
Fushë Kosovë	5
Ferizaj	17
Gjakovë	8
Gjilan	18
Glogovc	26
Gracanice	5
Hani i Elezit	0
Istog	4
Junik	0
Kamenicë	0
Kaçanik	12
Kline	11
Klokot	0
Leposaviq	1
Lipjan	7
Malishevë	19
Mamush	0
Mitrovicë	32
Novobërdë	0
Obiliq	2
Partesh	0
Pejë	12
Podujevë	6
Prishtinë	164
Prizren	26
Rahovec	2
Ranilluk	0
Shtime	0
Shtërpçë	6
Skenderaj	49
Suhareke	3
Viti	2
Vushtrri	12
Zubin Potok	0
Zveçan	0

18. APELET

Gjatë procesit Zgjedhor 2010/2011 PZAP-i, PZAP-i ka shqyrtuar dhe vendosur 15 apele. Natyra e apeleve ka qenë:

- a) Tërheqje nga lista e kandidateve 6 apele;
- b) Për procesin e emërimi të komisionarëve të KVV-e, 1 apel dhe
- c) Ndaj vendimeve të PZAP-it janë bërë 8 apele, në të gjitha këto raste PZAP-i, i ka shqyrtuar vendimet e tij.

19. PADIT E PARAQITURA NDAJ VENDIMEVE TE PZAP-IT NË GJYKATËN SUPREME

Në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, lidhur me Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2010/2011, nga subjektet politike, ndaj vendimeve të PZAP-it janë paraqitur 19 padi. Prej të cilave 1 padi është miratuar, 10 padi janë refuzuar dhe 8 padi janë hedhë poshtë si të palejuara nga Gjykata Supreme

20. RASTET E DORËZUARA NË PROKURORINË E SHTETIT

Në Prokurorinë e Shtetit PZAP-i, i ka dorëzuar 198 raste të cilat kanë të bëjnë me rastet e përgjegjësive individuale dhe që përmbajnë elemente të veprës penale që janë shkaktuar gjatë procesit zgjedhor 2010/2011 dhe që janë në kundërshtim me Kodin Penal të Kosovës (KPK). Për zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010 janë dorëzuar në Prokurorin Shtetërore 133 raste, për rivotimin e datës 9 janar 2011 janë dorëzuar në Prokurorin Shtetërore 58 raste dhe për rivotimin e datës 23 janar 2011 janë dorëzuar në Prokurorin Shtetërore 7 raste. PZAP – i ka njoftuar KQZ që të ruaj materialin e procesit zgjedhor të datës 12 dhjetor 2010 për 102 Qendra të Votimit (QV), për rivotimin e datës 9 janar 2011 për 32 QV, dhe

për rivotimin e datës 23 janar 2011 për 8 QV nga se materialet e të gjitha këtyre QV janë objekt i hetimit nga Prokuroria e Shtetit.

SANKSIONET: Gjobat shqiptuara ndaj Subjekteve Politike

Nr	Subjekti politik	Nr. Ankesave qe kanë rezultuar me gjoba ndaj SP	Shuma e gjobës	Pagesa e gjobës	Mbetja e borxhit
1	PDK	37	148,400.00	148,400.00	0.00
2	LDK	23	88,050.00	88,050.00	0.00
3	AAK	21	77,600.00	77,600.00	0.00
4	AKR	11	38,850.00	38,850.00	30.00
5	LDD	4	9,200.00		9,200.00
6	LVV	4	6,250.00	6,250.00	0.00
7	FER	2	3,050.00		3,050.00
8	KDTP	2	3,050.00	3,050.00	0.00
9	SLS	1	3,000.00	3,000.00	0.00
Total:		105	377,450.00	365,200.00	12,250.00

PZAP ka autoritet ligjor të marrë vendime në pretendimet se janë shkelur dispozitat e Kodit Sjelljes si dhe të shpallë sanksione dhe kompensime në përputhje me ligj.

PZAP- i, ka shqiptuar gjoba Subjekteve Politike dhe atë si në vijim:

- Shuma e gjobave të shqiptuara ndaj Subjekteve Politike është gjithsejtë: 377,450.00
- Shuma e gjobave të paguara nga Subjektet Politike është gjithsejtë: 365,200.00 €
- Shuma e gjobave të papaguara nga Subjektet Politike është gjithsejtë: 12,250.00 €

Subjektet Politike shumat e gjobave i paguajnë në llogari të Buxhetit të Republikës së Kosovës në Xhironlogarinë : 1000400070003381.